



07/14

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA KOMUNA-
MALISHEVË/DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE NË MALISHEVË

Në bazë të nenit 67 dhe 68 të Ligjit për Zyratë Publik Nr. 06/L-114, të nenit 8 të Ligjit të Punës nr: 03/L-212, në bazë të nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017. Në bazë të Udhëzimit Administrativ Për Kujdesin Parësor Shëndetësor Nr. 04/2020, nenit 15, si dhe në bazë të njoftimit të Masës Monetare të dt: 24.01.2023 të Zyrës për Buxhet dhe Financa në Komunën e Malishevës – DSHMS Malishevë shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS.

Titulli i vendit të punës: Infermier/e i Përgjithshëm/e në QKMF- Dr. “ Shpëtim Robaj” – Malishevë.

Institucioni:	Komuna e Malishevës
Departamenti/ Drejtoria:	Drejtoria Për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale- QKMF
Lloji i pozitës:	Nëpunës i Shërbimit Publik
Numri i Pozitave	(20) Njëzet.
Titulli i mbikëqyrësit	Drejtori i QKMF-së
Grada/ Koeficienti	4.8 -H-68
Kohëzgjatja e emërimit	Me kohë të pa caktuar
Periudha provuese	6 (gjashtë) muaj

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin e zyrtarëve publikë

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotëroj njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët.
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale.
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik.

Detyrat dhe përgjegjësitë.

- Pranon dhe triazhon pacientët në QKMF
- Përgatitë pacientët për vizitë mjekësore
- Kryen punë administrative shëndetësore
- Përgjigjet për participimin e pacientëve
- Kryen sipas nevojës punët e kartotekës, intervencës, patronazhit, terrenit dhe edukimit
- Bënë aplikimin e terapisë si dhe përcjelljen e shenjave vitale gjatë kohës së transportit të pacientëve,
- Bënë bartjen e pacientëve prej shërbimit deri në ambulant dhe anasjelltas
- Sipas urdhërit të shefit të mjekësisë familjare kryen edhe punë tjera
- Për punën e vet i përgjigjet Kryeinfermierit dhe Shefit të Sektorit të Mjekësisë Familjare.

Dokumentet e nevojshme:

- Diplomën e fakultetit të Infermierisë - Bachelor ose diplomën e Shkollës së Mesme të Mjekësisë (kopjen e noterizuar).
- Licencën e punës me afat (kopjen e noterizuar).
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës, diploma duhet njihet nga MPB.
- Formulari i aplikimit i plotësuar
- Rezymeja personale (CV)
- Certifikatën e lindjes, (origjinali).
- Certifikatën që nuk është nënë hetime ose i dënuar në Gjykatë (origjinali).
- Letërnjoftimin të fotokopjuar .
- Certifikatën e mjekut për punë (pas përzgjedhjes nga komisioni)
- Përvoja e punës (e dëshirueshme)

Dokumentet duhet të jenë në kopje dhe të noterizuara, siç janë të renditura më lart.

Afati dhe mënyra e aplikimit:

30 ditë nga dita e publikimit të konkursit mbetet vetëm njoftim, ndërsa konkursi mbetet i hapur 15 ditë, aplikacionet dorëzohen nga data 27.02.2023 deri me dt: 13.03.2023 Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyrën e Personelit në QKMF (ditëve të punës prej: 07 deri ora 15).

- Konkursi shpallet në linkun: <http://konkursi.rks-gov.net> si dhe në tabelën e shpalljeve në KK-Malishevë dhe në QKMF. Të gjitha njoftimet e tjera dhe shpalljet vendosen në tabelën e shpalljeve në QKMF.

-Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pa kompletuara nuk do të pranohen.

Malishevë.
27.01.2023

**DIREKTORI I DSHMS-së**
Hajdin Berisha